

VENDIM
Nr. 77, datë 7.6.2016

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 19, germa “a”, dhe 98, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike të ERE-s, në lidhje me miratimin e Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”,

konstatoi:

- Në nenin 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se Rregullat e Tregut të Energjisë elektrike të cilat duhet të jenë në harmoni me Modelin e Tregut miratohen nga ERE, pas propozimit të OST sh.a.

- Në nenin 97/3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se është Këshilli i Ministrave organi përgjegjës që miraton Modelin e Tregut, pas propozimit të tij nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

- Në datë 30.3.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 244, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.”.

- OST me shkresën e saj nr. 3299 prot. datë 31.5.2016, paraqiti në ERE për miratim draftin e “Rregullave të Tregut”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti